



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr 245 prot

Korçë më 10.09.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, Përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar .

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësues të Teorisë dhe/ose Praktikës Profesionale me kohë të plotë, për "Drejtimin Hoteleri - Turizëm".

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësues të teorisë dhe/ose praktikës profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë Përkatese niveli Master profesional ose të barazvlefshëm me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) Të ketë të paktën 1 (nje) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

- 6. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :
 - a) Letër motivimi për pozicionin;
 - b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
 - c) Kartën e identitetit,
 - d) Diplomën
 - e) Librezën e punës
 - ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
 - f) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
 - gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
 - h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit të AFP-së brënda datës.....19.09.2025-

3. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 datë 27.5.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë ,menaxhimin e burimeve njerëzore ,përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve ,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimin e vazhduar profesional të personelit ", i ndryshuar

